



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

## GJYKATA THEMELORE PEJË

---

AD/GJTHPE/.nr.12/23

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarit B.SH, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga M.H, rruga “E.E”, nr..., Pejë, pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 13.12.2023, mori këtë:

### A K T V E N D I M

**REFUZOHET** ankesa disiplinore e parashtruar nga M.H, nga Peja, ndaj gjyqtarit B.SH, **SI E PABAZUAR.**

### A r s y e t i m

Me datë 27.11.2023, M.H, me banim në rrugën “E.E”, nr... në Pejë, ka parashtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit B.SH, për shkak të shkeljeve disiplinore nga neni 3 lidhur me nenin 5 par.1 nënpar.1.2 dhe 1.3, par.2 nënpar.2.1, 2.2, 2.3, 2.5, 2.6, 2.7 dhe 2.15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve si dhe nenin 5 dhe 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike, me arsyetimin se lënda ku këtu parashtruesi i ankesës është palë e paditur, ka qenë në punë te një gjyqtarë tjetër i cili ka nxjerrë Aktvendim për ndërprerje të procedurës dhe se për parashtrimin padisë ndaj tij ka kuptuar vetëm pasi e ka pranuar aktvendimin në fjalë. Tutje, lënda i është ndarë gjyqtarit B.SH, i cili ka caktuar seancë për datën 07.11.2023 ndërsa, këtu parashtruesi i ankesës në cilësi të palës me datë 06.11.2023, ka dorëzuar në gjykatë kërkesë për shikim dhe përshkrim të shkresave të lëndës, për të cilën kërkesë gjyqtari ende nuk ka vendosur edhe pse konform nenit 2 pika 2.3 të LPK-së, është përcaktuar se gjykata nuk mund të refuzojë shqyrtimin dhe vendosjen mbi kërkesat që janë në kompetencën e saj, e me këtë veprim ia ka pamundësuar të shfrytëzoj të drejtën e tij për ushtrimin e ankesës. Po ashtu, parashtruesi i ankesës ka theksuar se në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 07.11.2023, gjyqtari B.SH ndaj tij ka vepruar në mënyrë të pandershme dhe të padenjë për faktin se e ka ulur pas paditësit G.B dhe përfaqësuesit të tij, salla është mbajte në zyrë të gjyqtarit e jo në sallë të gjykimeve dhe ankuesi thekson se nuk ka pas tavolinë pune, duke e trajtuar kështu në mënyrë të pabarabartë në raport me palën paditëse. Përfundimisht, i njëjti ka shtuar se pas përfundimit të seancës gjyqësore, gjyqtari ka filluar t’i jap këshilla juridike përfaqësuesit të paditësit andaj, me këto veprime vlerëson se gjyqtari përveç që ka kryer shkelje të natyrës disiplinore gjithashtu, është duke e keqpërdor detyrën zyrtare. Si provë ankesës disiplinore ja ka bashkëngjitur Aktvendimin C.nr.2624/21, të datës 18.11.2021, për ndërprerje të procedurës për shkak të vdekjes së paditësit, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.3537/17, të datës 07.10.2021 si dhe Kërkesën e datës 06.11.2023 për shikimin dhe përshkrimin e shkresave të lëndës

Me datë 29.11.2023, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruar nga M.H, ndaj gjyqtarit B.SH.

Gjyqtari B.SH, në deklaratën e tij ka theksuar se lënda ku palë e paditur është parashtruesi i ankesës, i është ndarë në punë pasi që e njëjta është kthyer në ri procedurë. Lidhur me pretendimet e ankuesit se i njëjti nuk ka qenë i informuar me lëndën e cila është zhvilluar ndaj tij dhe këtë fakt e ka kuptuar kur është ndërprerë procedura sipas Aktvendimit C.nr.2624/21 e i cili vendim është marr nga një gjyqtar tjetër, gjyqtari Sh. thekson se pretendimi i tillë nuk qëndron pasi që nga shkresat e lendes C.nr. 256/15, vërtetohet fakti se i njëjti ka marr pjesë në seanca duke paraqitur edhe kundërshtime, rrethanë kjo e cila vërtetohet në bazë të shkresave të lëndës si dhe nga vet i padituri në ankesën disiplinore ku thekson se ankesa e të paditurit M.H është aprovuar dhe lënda është kthyer në rigjykim dhe rivendosje sipas Aktvendimit të Gjykatës së Apelit me shifrën Ac.nr. 3537/17. Sa i përket kërkesës së ankuesit që t'i sigurohen shkresat e lëndës, gjyqtari thekson se i njëjti i posedon të gjitha shkresat e lendes dhe kjo vërtetohet nga fakti se të gjitha shkresat i janë dorëzuar më herët gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore, ku i njëjti ka marr pjesë në seanca dhe ka parashtruar edhe kundërshtime. Ndërsa sa i përket pretendimit të ankuesit se *gjyqtari i çështjes ka vepruar me pandërgjegjshmëri dhe në mënyrë të padenjë për faktin se mua më cakton vendin e uljes në zyrën e gjykatës prapa paditësit G.Bdhe përfaqësuesit të tij avokatit O.K po në këtë zyre unë nuk kam pasur tavolinë pune që të shfrytëzoj*, gjyqtari ka deklaruar se duke i pas parasysh kushtet e gjykatës në të cilat punohet nuk ka pasur asnjë privilegj në raport me palët tjera pasi që edhe palët paditëse nuk kanë pasur tavolinë pune e as ndonjë tretman tjetër, sa i përket faktit se i njëjti është ulur afër paditësit i njëjti në gjykatë është paraqitur me vonës pas fillimit të seancës ku kjo është e konstatuar në procesverbalin e seancës së datës 07.11.2023 dhe duke pasur parasysh kufizimin e hapësirës në gjykatë i njëjti është ulur aty e që në rastin konkret nuk paraqet asnjë kufizim ligjor. Sa i përket pretendimit se të njëjtit i janë mohuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe Ligj për një gjykim të drejtë, këto pretendime kanë të bëjnë me aspektin ligjor që vlerësohen nga instancat më të larta të gjyqësorit. Gjithashtu, i njëjti ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet se i ka dhënë këshilla të autorizuarit të paditësit pas përfundimit të seancës, por kjo është vetëm një pretendim imagjinar i të njëjtit dhe se të gjitha pretendimet e të njëjtit kanë qellim të ushtrimit të presionit në raport me gjyqtarin e çështjes. Për tu konsideruar si shkelje disiplinore veprimet e gjyqtarit të cekura më lartë duhet të bëhen me dashje dhe të argumentohet dashja apo të paraqiten prova konkrete që paraqesin apo argumentojnë dashjen për të vepruar kundërligjshëm apo për të shkel detyrat zyrtare siç pretendon ankuesi mirëpo të gjitha te cekurat në ankesën e tij nuk qëndrojnë.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj gjyqtarit B.SH, së bashku me deklaratën e tij, ka gjetur se ankesa disiplinore është dukshëm joserioze dhe e pabazuar.

Lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës disiplinore se gjyqtari ka shkel ligjin, ka shkel detyrat e tij zyrtare si gjyqtar dhe ka kryer të gjitha shkeljet e tjera disiplinore të listuara në nenin 5 par.2 pika 2.1 deri në pikën 2.7 dhe pikën 2.15 të Ligjit për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve si dhe ka shkel nenin 5 dhe 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike, autoriteti kompetent gjen se parashtruesi i ankesës në asnjë mënyrë dhe me asnjë argument nuk i ka arsyetuar shkeljet disiplinore mbi bazën e të cilave e ka parashtruar ankesën, përkundrazi i njëjti vetëm i ka parafrazuar dispozitat ligjore në fjalë duke mos dhënë asnjë argument bindës dhe asnjë provë që do ta mbështeste pretendimin e tij për shkelje disiplinore nga ana e gjyqtarit.

Fakti se gjyqtari nuk i është përgjigje kërkesës së tij si palë e paditur për shikimin dhe përshtkrimin e shkresave të lëndës ku është palë, nuk përbën shkelje të natyrës disiplinore ashtu siç është

përcaktuar me Ligjin për Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ndërsa, fakti se gjyqtari pas përfundimit të seancës i ka ofruar këshilla juridike të autorizuarit të palës paditëse, mbetet vetëm një pretendim i parashtruesit të ankesë meqë i njëjti nuk e ka dëshmuar në asnjë formë se gjyqtari pas përfundimit të seancës i ka dhënë këshilla të autorizuarit të palës apo se çfarë këshilla juridike i ka dhënë gjyqtari të autorizuarit të palës paditëse pas përfundimit të seancës.

Përfundimisht, pretendimet e parashtruesit të ankesës se gjyqtari e ka trajtuar në mënyrë të pandershme, të padenjë dhe në mënyrë të pabarabartë në raport me palën paditëse duke e ulur në seancë pas paditësit dhe përfaqësuesit të tij dhe se gjatë seancës nuk ka pas tavolinë pune, autoriteti kompetent i gjen si dukshëm joserioze duke pas parasysh se është fakt i ditur se si pasojë e infrastrukturës së objektit të Gjykatës një numër i konsiderueshëm i seancave gjyqësore mbahen në zyrë të gjyqtarëve, të përshtatura me qëllim të ofrimit të kushteve elementare për mbajtjen e seancave gjyqësore ashtu që në asnjë zyrë e madje, në asnjë sallë të gjykimit, nuk ekzistojnë kushte të atilla që ia mundësojnë gjyqtarit ofrimin e komoditetit apo ofrimin e tavolinave të veçanta për njërin palë.

Andaj, nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenin 7 par.3 pika 3,1 dhe 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD/GJTHPE/.nr.12/23, me datë 13.12.2023.**

**Kryetari i Gjykatës**

---

**Armend Berisha**

*Vendimi i dorëzohet:*

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtarit B.SH*
- 3. Parashtruesit të ankesës – M.H*